

**Shoqeria**  
**“ A.G.E. CO&CO “ Sh.P.K.**



## **V E N D I M**

**Nr. Gjashte**

### **I ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE PER ZMADHIMIN E KAPITALIT**

**Une, Gojart LACI, Ortak i Vetem i Shoqerise “A.G.E. CO&CO ” Sh.P.K., Shoqeri e regjistruar si person juridik ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane me Vendimin Nr. 28413, date 18.10.2002, me Kapital Themeltar 2.084.500 leke, me seli Rruga “Mihal GRAMENO “, Pa. Nr. 61, Shk. Nr. 1, Ap. Nr. 5 - Tirane,**

**Mora ne shqyrtim sot, me date 10.03.2007, prane selise se Shoqerise, problemet ne vijim:**

**1. Miratimi i Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar Ahmet Stojna, emeruar me Vendimin Nr. 28413/5, date 07.03.2007, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise mbi bazen e vleresimeve te kapitalit te saj, sipas bilancit te Shoqerise, te mbyllur me 31.12.2005.**

**2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te Shoqerise me shumen prej 2.622.500 leke, shume qe rezulton nga perfshirja ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise e nje pjese te fitimit neto te Shoqerise, te pashperndare, ne perputhje me Bilancin e saje, te mbyllur me 31.12.2005.**

Nga shqyrtimi i dy problemeve te mesiperme, ne baze edhe te Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar, zotit Ahmet Stojna, rezulton se sipas Bilancit te Shoqerise, mbyllur me date 31.12.2005, fitimi neto i Shoqerise, i pashperndare, eshte 2.760.896. Propozimi i Ekspertit Kontabel te Autorizuar eshte qe nga fitimi i pashperndare shuma 2.622.500 leke te perdoret per zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, ndersa pjesa qe mbetet te perdoret per reze domosdoshme.



Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te Shoqerise, ne perputhje edhe me Raportin e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, rezulton i mbeshtetur ne dokumentet financiare te Shoqerise si dhe justifikohet me rritjen e aktiveve reale te saja.

Ne perfundim te shqyrtimit te te dy problemeve te mesiperme,

## V E N D O S A

1. Miratimi i Raportit te Ekspertit Kontabel te Autorizuar Ahmet Stojna, emeruar me Vendimin Nr. 28413/5, date 07.03.2007, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per zmadhimin e Kapitalit Themeltar te Shoqerise, mbi bazen e vleresimeve te Kapitalit te saj, ne perputhje me Bilancin e Shoqerise, te mbyllur me 31.12.2005.

2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar te Shoqerise me shumen prej 2.622.500 leke, shume qe rezulton nga perfshirja ne Kapitalin Themeltar te Shoqerise e nje pjese te fitimit neto te Shoqerise, te pashperndare, ne perputhje me Bilancin e saja, te mbyllur me 31.12.2005.

3. Me kete zmadhim Kapitali Themeltar i Shoqerise nga 2.084.500 leke, qe eshte, behet 4.707.000 leke.

Pas ketije zmadhimi Kapitali Themeltar perbehet nga 4.707 pjese te Kapitalit Themeltar, duke pasur secila pjese nje vlefte prej 1.000 leke, te cilat zoterohen prej Ortakut te Vetem te Shoqerise si vijon:

Zoti Gojart Laci zoteron 4.707 pjese te Kapitalit Themeltar te Shoqerise, me vlefte 4.707.000 leke, e barabarte me 100 ( njeqind ) perqind te Kapitalit Themeltar.

Ortaku i Vetem i Shoqerise

Gojart LACI

